

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XIX, nr. 5779  
E premte, 17 maj 2019  
çmimi 0.40 €

## ShBA-ja: S'ka viza amerikane për zyrtarët e korrumpuar të Kosovës

Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) fillon marrjen e masave konkrete ndaj zyrtarëve që janë të përfshirë në krim dhe korrupsion



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

### AKTUALE

**LËRENI PRESIDENTIN HASHIM THAÇI TË REALIZOJË T'I DREJTAT E SHQIPTARËVE TË KOSOVËS LINDORE SEPSE KA TË DREJTË F.11**

Spiro BUTKA



**HARADINAJ VIZITON POLICINË, OFRON PËRKRAHJE PËR KËTË INSTITUCION F. 3**

**ONKOLOGJIA, 20 MIJË SHËRBIME PËR KATËR MUAJ F. 6**

**PD-JA DHE LSI-JA JAPIN SINJALE SE DO TË MARRIN PJESË NË ZGJEDHJE F. 2**

### EKONOMI

**INSPEKTORATI I PUNËS, 20 INSPEKTORË MË TEPËR F. 8**

**INAUGUROHET ODA EKONOMIKE KOSOVË - ZVICËR F. 9**

### SPORT

**ISLAMI: NUK KEMI FRIKË NGA PRISHTINA, TITULLI ËSHTË I 'NIKLIT' F. 12**

KUVENDI I KOSOVËS KA MBAJTUR SEANCË TË JASHTËZAKONSHME

# Miratohet rezoluta për gjenocidin serb në Kosovë



Kuvendi i Kosovës me votat e të gjitha partive politike ka arritur të miratojë të enjten rezolutën, me të cilën e bënë përgjegjëse Serbinë për gjenocid në Kosovë. Rezoluta përmend vendet ku janë kryer masakrat dhe vrasjet, dhunimet seksuale të 20 mijë femrave,

dëbimi i më shumë se 1 milion shqiptarëve, të zhdukurit, si dhe dëmet materiale. Po ashtu, rezoluta obligon institucionet e Kosovës që të kërkojnë drejtësi. Sipas këtij dokumenti, 15 janari do të jetë dita e përkujtimit të gjenocidit në Kosovë.



## Ukshin Hoti ishte veprimtar, intelektual dhe ideolog

FAQE 5

**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepcisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijbiznesi.com  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

## Monika Kryemadhi takon Nancy Pelosin

**TIRANË, 16 MAJ** - Kryetarja e Lëvizjes Socialiste për Integrim, Monika Kryemadhi, ndodhet për një vizitë pune në Shtetet e Bashkuara. Në vazhdim të vizitës zyrtare, ajo ka zhvilluar një takim me Nancy Pelosin, kryetaren e Dhomës së Përfaqësuesve në Kongresin Amerikan. Në një postim në rrjetet sociale, Kryemadhi ka njoftuar se ka biseduar me Pelosin për marrëdhënien e Shqipërisë dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Ndër të tjera,

Kryemadhi shprehet se "kryetarja Pelosi është një model shumë i fortë për të gjitha gratë në botë, veçanërisht në Shqipëri. Kemi nevojë për më shumë gra e vajza në politikën shqiptare, për ta bërë Shqipërinë shtëpinë tonë".

Kryemadhi ka thënë se ishte kënaqësi e madhe ta takojë Nancy Pelosin, spikeren e Dhomës së Përfaqësuesve në Kongresin Amerikan dhe të bisedojë me të mbi marrëdhënien e Shqipërisë dhe Shteteve të

Bashkuara të Amerikës. "Kryetarja Pelosi është një model shumë i fortë për të gjitha gratë në botë, veçanërisht në Shqipëri. Kemi nevojë për më shumë gra e vajza në politikën shqiptare, për ta bërë Shqipërinë shtëpinë tonë. Pres me padurim për ta vazhduar diskutimin me një grua kaq të fuqishme për mënyrën se si duhet ta fuqizojmë marrëdhënien tonë me ShBA-në dhe të përfitoj nga përvoja e saj për të ndërtuar një Shqipëri më të fortë", ka shkruar

Kryemadhi. Ndërkohë, Monika Kryemadhi ka zhvilluar edhe takime të tjera gjatë vizitës së saj Uashington. Ajo është prituri në Departamentin Amerikan të Shtetit nga Susan K. Falatko, drejtore e Zyrës për Çështjet e Evropës Qendrore e Jugore. Kryemadhi ndau me Falatko opinionet dhe shqetësimet lidhur me situatën e rëndë politiko-sociale në Shqipëri si dhe angazhimin politik të LSI-së në këtë çast tepër delikat për



vendin. Ajo nënvizoi rolin e veçantë dhe vëmendjen e ShBA-së për Shqipërinë, bazuar edhe në vlerat e jashtëzakonshme të demokracisë që Amerika përfaqëson për vendin tonë.

## PD-ja dhe LSI-ja japin sinjale se do të marrin pjesë në zgjedhje

Partia Demokratike dhe Lidhja Socialiste për Integrim, duke vendosur t'i çojnë anëtarët e tyre në komisionet e administrimit të zgjedhjeve, kanë dhënë sinjale se do të futen në zgjedhjet vendore të 30 qershorit

**TIRANË, 16 MAJ** - Partia Demokratike dhe Lidhja Socialiste për Integrim kanë dhënë sinjale se do të futen në zgjedhje pasi dy partitë opozitare kanë vendosur t'i çojnë anëtarët e tyre në komisionet e administrimit të zgjedhjeve. Edhe pse në arsyetimin e sekretarit të PD-së, Gazmend Bardhi, thuhet se ky është një vendim për t'i mbrojtur "manipulimet e procesit zgjedhor", në fakt ky është sinjali i parë që opozita po përgatit terrenin për t'u futur në zgjedhje. "Partia Demokratike dhe Lëvizja Socialiste për Integrim kanë informacion zyrtar se në KZAZ janë duke u kryer manipulime të rënda të procesit zgjedhor, që nis me regjistrim të paligjshëm të kandidatëve për kryetar bashkie. Për këtë arsye, për të dokumentuar dhe çmontuar këtë paligjshmëri, PD-ja dhe LSI-ja mund ta shfrytëzojnë ligjin për t'i dërguar anëtarët që i takojnë në KZAZ për të provuar

ligjërisht që Edi Rama nuk garanton zgjedhje legjitime edhe kur nuk ka kundërshtarë përballë. Në ditët në vijim do t'i faktojmë të gjitha paligjshmëritë e kryera nga përfaqësuesit e Edi Ramës gjatë procesit", thuhet në reagimin e Gazmend Bardhit. Pak ditë më parë Lulzim Basha uli tonet ndaj qeverisë dhe foli për "ndërmjetësim ndërkombëtar për krizën", pas kritikave me "artileri të rëndë" që mori në bllok nga ambasadat për dhunën në protestën e 11 majit. Ndërkohë nga radhët e drejtuesve të Partisë Socialiste vijnë mesazhe force që tregojnë për tensionim të mëtejshëm të situatës. Numri dy i Partisë Socialiste, Taulant Balla, deklaroi të enjten në Kuvend se mazhoranca do të shkojë në zgjedhje më 30 qershor pa opozitën dhe kjo datë nuk ndryshon. Kreu i deputetëve të PS-së shkoi edhe më tej në reagimin e tij teksa deklaroi se "30 qershorin



nuk e luan as topi". Balla e cilësoi opozitën, që proteston prej muajsh për qeveri tranzitore dhe për zgjedhje normale, si një grup huliganësh që do të përballen me ligjin. "Zgjedhjet do të mbahen më 30 qershor dhe 'nuk e

luan as topi'. Dhuna në protestat e opozitës urdhërohet politikisht dhe kriminalisht nga Sali Berisha dhe Lulzim Basha", deklaroi Balla. Më 29 maj, në orën 12:30, të gjithë shqiptarët do ta marrin

lajmin e mirë nga Komisioni Evropian për ta rekomanduar përfundimisht fillimin e bisedimeve për anëtarësim. Përpjekja e fundit për të penguar këtë lajm të mirë do të bëhet më 25 maj nga huliganët", ka thënë Balla.

## Kryebashkiaku i Nju Jorkut, në garën për nominimin demokrat për president

**UASHINGTON, 16 MAJ** - Kryebashkiaku i Nju Jorkut, Bill de Blasio, do ta kërkojë nominimin presidencial demokrat për zgjedhjet e 2020-s, pavarësisht prej sinjaleve dekurajuese nga mediet amerikane dhe sondazhet që sugjerojnë se ai përballat me një betejë të fortë. De Blasio bëhet kështu pretendenti demokrat i 23-të që synon ta sfidojë presidentin Donald Trump. "Donald Trump duhet ndalur. Unë jam Bill de

Blasio dhe kandidoj për president, sepse është koha që ne t'i vendosim të parët punëtorët amerikanë", tha kryebashkiaku i Nju Jorkut.

58 vjeçi De Blasio, që ka kandiduar në vitin 2013 si një majtist apolitik, tha se paratë e vendit janë në duart e gabuara dhe shtoi se ai e di si ta sfidojë Trumpin sa iu takon ndryshimeve klimatike, një çështje për të cilën presidenti ka demonstruar skepticizëm.

Si kryebashkiaku demokrat i qytetit më të madh në vend për pesë vjetët e shkuara, ai u zgjodh në post në vitin 2013. Pavarësisht një teze të hershme, se detyra e kryebashkiakut të Nju Jorkut është e dyta më e vështira dhe më prestigjiozja në Amerikë, pas asaj të presidentit De Blasio, i quajtur shpesh edhe "zogu i madh" për shkak të gjatësisë së tij të spikatur 1.97 metra, është një nga të paktët që beson hapur te mundësitë e tij.



Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) fillon marrjen e masave konkrete ndaj zyrtarëve që janë të përfshirë në krim dhe korrupsion

## ShBA-ja: S'ka viza amerikane për zyrtarët e korrumpuar të Kosovës

Personat që janë të përfshirë në rastet e mëdha të korrupsionit dhe krimit të organizuar nuk do të mund të marrin viza për të udhëtuar në Amerikë. Kështu ka bërë me dije të enjten Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) nëpërmjet një deklarate për medie. Ambasada Amerikane ka vlerësuar se qytetarët e Kosovës meritojnë një sistem drejtësie që mban individët përgjegjës për veprimet e tyre korruptuese. Profesori i qeverisjes amerikane, Ilir Ibrahim, ka thënë se ky veprim i ambasadës tregon se Amerika do të merret më seriozisht me fenomenet e këqija dhe të ndërmarrë masa konkrete



**EPOKA  
ERE** Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 16 MAJ - Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Kosovë nëpërmjet një deklarate për media ka bërë me dije se personat që janë të përfshirë në rastet e mëdha të korrupsionit nuk do të mund të marrin viza për të udhëtuar në Amerikë. "Qytetarët e Kosovës meritojnë një sistem drejtësie që mban individët përgjegjës për veprimet e tyre korruptuese. Lidhur me këtë, Ambasada e ShBA-së është duke ndërmarrë hapa për të siguruar që individëve të cilët janë të përfshirë në rastet e mëdha të korrupsionit të mos u lëshohen vizat për udhëtim në Shtetet e Bashkuara për biznes apo turizëm", është thënë në komunikatën e Ambasadës së ShBA-së në Prishtinë. Po në këtë komunikatë janë përmendur rastet e korrupsionit

dhe krimit 'Pronto', 'Viza italiane', 'Ikja nga burgu i Dubravës', 'Toka' dhe 'Apex' për të cilat Ambasada Amerikane ka shprehur shqetësimin se si askush deri më tani nuk është duke u mbajtur përgjegjës. "Ne do të vazhdojmë ta shprehim publikisht shqetësimin tonë, se askush nuk është duke u mbajtur përgjegjës, përfshirë zyrtarë të Kosovës, për korrupsionin dhe krimin e organizuar që janë të qarta në rastet 'Pronto', 'Viza italiane', 'Ikja nga burgu i Dubravës', 'Toka' dhe 'Apex', si dhe në raste të tjera të ngjashme", është theksuar në këtë deklaratë.

Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës ka sqaruar se zyrtarët konsullorë shqyrtojnë faktet për çdo aplikim për vizë, duke përfshirë edhe informatat negative për aplikuesit. "Është praktikë e zyrtarëve konsullorë që t'i shqyrtojnë faktet për çdo aplikim për vizë,

duke përfshirë edhe çdo informatë negative lidhur me aplikuesin dhe që ta përcaktojnë përshtatshmërinë për marrje të vizës në bazë të ligjeve të ShBA-së. Sipas nevojës, ne vazhdimisht i peshojmë akuzat dhe dëshmitë për korrupsionin dhe krimin e organizuar gjatë vendimmarrjes për viza, në mënyrë që t'i kufizojmë ata që kontribuojnë në këto probleme nga marrja e vizave për udhëtim në Shtetet e Bashkuara", është thënë në deklaratën për medie të ShBA-së. Vendimi i Ambasadës së Amerikës, për të mos u dhënë viza udhëtimi zyrtarëve të korrumpuar në Kosovë, është komentuar nga profesori i qeverisjes amerikane, Ilir Ibrahim. Ai ka thënë të enjten për gazetën "Epoka e re" se ky veprim i Ambasadës së ShBA-së tregon se do të fillojë të merret më seriozisht me fenomenet e

këqija dhe të marrë masa konkrete. "Deklarata e fundit e Ambasadës Amerikane tregon se ky vend do të fillojë të merret më seriozisht me fenomenet e këqija dhe të marrë masa konkrete. Por shpresoj shumë që të mos ndalen me kaq dhe shpresoj edhe më shumë që qytetari kosovar të fillojë ta luajë rolin e vet për t'u thënë jo fenomeneve të këqija", ka deklaruar Ibrahim. Ai ka theksuar se deklaratat kaq të drejtpërdrejta, përveç dënimit të këtij fenomeni, u bëjnë thirrje qytetarëve të Kosovës t'i mbajnë përgjegjës politikanët e zhytur në korrupsion dhe ata që nuk e luftojnë atë. "Korrupsioni tanimë është bërë një shqetësim edhe për përfaqësues të vendeve mike dhe këtë e kemi parë nga deklaratat e ambasadorëve si ai amerikan dhe anglez, por edhe nga ambasadorë të tjerë. Deklaratat kaq të drejtpërdrejta

kanë një gjë të përbashkët. Përveç dënimit të këtij fenomeni, ato u bëjnë thirrje qytetarëve të Kosovës t'i mbajnë përgjegjës politikanët të cilët ose janë të zhytur në korrupsion, ose me mosluftimin e tij po e mundësojnë atë", është shprehur Ibrahim, duke shtuar se nuk është normale që përfaqësuesit e vendeve të huaja të shprehin më tepër shqetësim sesa qytetarët e Kosovës për fenomenet e këqija të shoqërisë. "Në demokraci qytetari e ka fjalën kryesore dhe ai shprehet përmes votës. Por në raste kur kemi fenomene të këqija, siç është korrupsioni apo nepotizmi, atëherë qytetari duhet ta ngre zërin. Nuk është normale që përfaqësues të vendeve të huaja të shprehin më tepër shqetësim se sa qytetari kosovar për fenomenet e këqija të shoqërisë", ka theksuar Ibrahim.

## Haradinaj viziton policinë, ofron përkrahje për këtë institucion

PRISHTINË, 16 MAJ (ER) - "Kosova e ka interes jetik që ta përkrahë policinë, t'i fuqizojë kapacitetet operative të policisë dhe ta mbështesë atë në bazë ligjore, në tema që ia garantojnë operimin e suksesshëm", kështu ka thënë kryeministri Ramush Haradinaj gjatë fjalës së tij pas një vizite pune që zhvilloi në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Kosovës. I shoqëruar edhe nga ministri i Financave, Bedri Hamza, si dhe ministri i Punëve të Brendshme, Ekrem Mustafa, kryeministri Haradinaj ka thënë se është e vërtetë që Kosova ka disa të arritura në fushën e sigurisë, por që sot bashkërisht kanë diskutuar edhe për ta parë mundësinë se si të vazhdohet më tutje që institucionet e sigurisë ta kenë një situatë

vepruese me bazë ligjore që i siguron në çdo etapë dhe çdo formë të operimit të tyre. "Kosova është vend specifik, e dalë nga lufta, ka shpallur pavarësinë e vet, pra është shoqëri e re, institucionet e vendit janë shumë të reja. Njëkohësisht është një kohë e tranzicionit kur përgjegjësitë nga mekanizmat ndërkombëtarë janë bartur dhe po barten te mekanizmat vendorë. Tash përgjegjësitë e plota i ka Policia e Kosovës në të gjithë vendin dhe janë përgjegjësi vërtetë të ndjeshme", ka thënë Haradinaj. Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, ka falënderuar kryeministrin Haradinaj dhe dy ministrat për vizitën në këtë institucion, duke thënë se janë shumë të kënaqur për përkrahjen që qeveria e ven-



dit po ia jep policisë. "Kjo përkrahje na obligon që ne më shumë të ofrojmë siguri për

vendin, për qytetarët tanë. U zotouam se do ta bëjmë maksimumin që ta shtojmë aktivitetin

tonë policor që qytetarët të ndihen sa më të sigurt", ka thënë Qalaj.

Kuvendi i Kosovës ka mbajtur seancë të jashtëzakonshme

# Miratohet rezoluta për gj



Kuvendi i Kosovës me votat e të gjitha partive politike ka arritur ta miratojë të enjten rezolutën me të cilën e bën përgjegjëse Serbinë për gjenocid në Kosovë. Rezoluta përmend vendet ku janë kryer masakrat dhe vrasjet, dhunimet seksuale të 20 mijë femrave, dëbimin e më shumë se një milion shqiptarëve, të zhdukurit, si dhe dëmet materiale. Po ashtu, rezoluta i obligon institucionet e Kosovës që të kërkojnë drejtësi. Sipas këtij dokumenti, 15 janari do të jetë dita e përkujtimit të gjenocidit në Kosovë

**EPOKA  
ERE** **Muhamet KOCI**

**PRISHTINE, 16 MAJ** - Me 79 vota për, Kuvendi i Kosovës ka miratuar rezolutën për gjenocidin, krimet kundër njerëzimit dhe krimet e luftës të ish-regjimit shtetëror serb në Kosovë. Pas disa orësh debat në seancë, që ishin të pranishëm edhe familjarët e viktimave, deputetët e të gjitha grupeve parlamentare kanë arritur t'i harmonizojnë qëndrimet e tyre rreth kësaj rezolute e cila fajëson Serbinë për gjenocid në Kosovë.

Në rezolutë përmenden të gjitha vendet ku janë kryer masakrat dhe vrasjet, dhunimet seksuale të 20 mijë femrave, si dhe dëbimi i më shumë se një milion shqiptarëve nga Kosova në vitin 1999.

Gjithashtu, rezoluta përmend edhe dëmet materiale, shkatër-

rimin e objekteve të ndryshme fetare dhe kulturore që regjimi serb i ka shkaktuar gjatë luftës. Ky dokument fajëson shtetin serb edhe për fshehje të së vërtetës, duke mos treguar për fatin e mijëra të zhdukurve. Me këtë rezolutë është paraparë që 15 janari të jetë dita e gjenocidit.

Kryetari i Komisionit Ad-hoc për hartimin e kësaj rezolute, Bilall Sherfi, i cili e ka prezantuar rezolutën pata deputetëve, ka thënë se ky dokument i obligon të gjitha institucionet që të kërkojnë drejtësi për viktimat. "Rezoluta obligon institucionet e Kosovës që të kërkojnë drejtësi, Kuvendin, Presidencën, Qeverinë e institucionet e drejtësisë. Kriminelët që janë gjallë do të përpiqemi t'i vëmë para drejtësisë dhe shteti i Serbisë do të jetë aty dhe do të vihet para drejtësisë. Ai shtet do të mbajë përgjegjësi për gjenocid

në Kosovë, kurse ne do të jemi këtu dhe nuk do të heqim dorë nga kërkimi i drejtësisë", ka thënë Sherifi.

## Themelimi i Tribunalit është i mundur

Në seancën e të enjtes deputetët kanë përkrahur edhe formimin e komisionit shtetëror për krijimin e Tribunalit për gjenocidin serb në Kosovë. Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, iniciues i kësaj çështje, ka thënë se 20 vjet pas luftës plaga më e madhe me të cilën përballet Kosova është mungesa e drejtësisë për viktimat e gjenocidit, të cilin shteti serb e ka ushtruar mbi popullin tonë gjatë viteve të luftës.

Ai ka treguar se për të gjitha këto krime dihen me emra dhe mbiemra shumica e kryesve të tyre.

Deri në fundin e vitit 2017, sipas Veselit, drejtësia ndërkombëtare ishte e vetmja përgjegjëse për trajtimin e krimeve të luftës në Kosovë. "Kosova i ka besuar thellësisht drejtësisë ndërkombëtare gjatë gjithë këtyre viteve. Kemi besuar se krimet gjenocidale të kryera nga Serbia në Kosovë do ta marrin përgjigjen e domosdoshme nga mekanizmat e kësaj drejtësie. Por, ne sot ndihemi thellësisht të zhgënjyer kur konstatojmë se kjo nuk ka ndodhur", është shprehur ai.

Më tej, Veseli ka treguar se propozimi i tij përfshin një proces ligjor dhe institucional, i cili do të kalojë nëpër disa faza deri në arritjen e ngritjes së tribunalit ndërkombëtar për gjenocidin serb mbi Kosovën, duke filluar me themelimin e komisionit shtetëror që bën konfirmimin, hulumtimin dhe klasifikimin e krimeve të luftës që kanë ndodhur gjatë luftës së fundit në Kosovë. Sipas Veselit, pas fazës së inicimit dhe të dokumentimit të krimeve do të vijë faza e lobimit për krijimin e tribunalit. "Kjo fazë fillon të zbatohet sapo komisioni shtetëror i ka të gatshme raportet e krimeve të dokumentuara në bazë të kriterëve ndërkombëtare. Kjo fazë nuk do të pushojë së funksionari

edhe nëse komisioni shtetëror e përfundon mandatin për të cilën është themeluar. Ministria e Drejtësisë dhe ajo e Punëve të Jashtme do ta kenë në vazhdimësi si përgjegjësi prioritarë realizimin e objektivave të kësaj faze", ka thënë Veseli, duke shtuar se ky komision do të shkojë të faktojë te çdo parlament në botë, te çdo mekanizëm politik, strategjik, te çdo mekanizëm i së drejtës humanitare, derisa të arrihet qëllimi final: drejtësia. "Gjykata ndërkombëtare që do të merret me këto krime, e kam thënë dhe dua ta ritheksoj edhe një herë, është e mundur, është e domosdoshme dhe është pashmangshme. Sot është dita që ky Kuvend të marrë një vendim, i cili i jep mundësi hapjes së kësaj epoke të këtij drejtësi. Së bashku. Si politikë. Si shtet. Si komb", ka thënë Veseli.

Shefi i grupit parlamentar i LDK-së, Avdullah Hoti, ka kërkuar që çështja e gjenocidit serb në Kosovë të zgjidhet para se të normalizohen marrëdhëniet me shtetin serb. Ai ka thënë se si LDK mbështetin çdo nismë për dënimin e regjimit serb. "Kjo çështje duhet të zgjidhet para se të normalizohen marrëdhëniet me Serbinë. LDK-ja mbështet çdo nismë për dënimin e regjimit serb. Ne

# Genocidin serb në Kosovë



përket formatit dhe qasjes në këtë propozim, duhet të rishikohet plotësisht", ka thënë Hoti.

Edhe lideri Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka shprehur skepticizëm se do të mund të arrihet krijimi i një tribunali ndërkombëtar për krimet serbe në Kosovë.

Kurti ka deklaruar se krimet e luftës, krimet kundër njerëzimit dhe gjenocidit janë, mbi të gjitha, krime të shtetit të Serbisë, që vetëm në luftën e fundit i vrau mbi 10 mijë civilë. Ai ka thënë se as Tribunali i Hagës nuk ka arritur të vë drejtësi për krimet serbe në Kosovë. "Gjatë kësaj

periudhe kanë qenë diku 4 000 dëshmitarë. Nuk kishte rehabilitim e as drejtësi për viktimat krahasuar me përmasat e krimit. Janë dënuar 72 serbë, 20 kroatë, 5 boshnjakë, 1 shqiptar dhe 1 maqedonas. Nuk janë dënuar dhjetëra mijëra ekzekutorë", ka thënë Kurti.

## Reagimet për fotografinë e Flora Brovinës

Gjatë një pushimi nga punimet e seancës, deputetja e PDK-së, Flora Brovina, ka publikuar para medieve një fotografi me pamje grafike të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë. Në fotografi shihen disa ushtarë serbë duke e dhunuar një 35-vjeçare para familjarëve të saj. Publikimi i fotografisë ka nxitur reagime të shumta, duke kërkuar nga mediet që të largohet fotografia.

Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës ka reaguar në lidhje me këtë fotografi duke tërhequr vërejtjen se "publikimi i këtyre pamjeve në mënyrë të plotë, pa censurë, i ka rikthyer kujtimet e tmerrshme të luftës

për shumë gra, burra e fëmijë që kanë përjetuar këtë tmerr, duke ritraumatizuar dhe duke i thelluar edhe më tej plagët dhe dhimbjet shpirtërore të tyre të përjetuara gjatë luftës". Edhe ish-presidentja e Kosovës, Atifete Jahjaga, ka kritikuar ashpër deputeten Flora Brovina për publikimin e fotos. "Një goditje e rëndë u është bërë sot mijëra të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë me publikimin e pamjeve që tregojnë dhunimin e një gruaje nga forcat ushtarake serbe gjatë luftës. Është e gërditshme, e neveritshme dhe e turpshme se si një deputete e Kuvendit të Kosovës, e cila dikur ngrëhte dorën kundër të drejtave të grave e burrave të dhunuar

seksualisht gjatë luftës në Kosovë, sot shfrytëzoi pikërisht godinën e Kuvendit për të publikuar para medieve një fotografi që thuhet se dokumenton aktin e dhunimit të një gruaje shqiptare nga tre ushtarë serbë", ka shkruar Jahjaga në profilin e vet në "Facebook", duke vlerësuar se publikimi i kësaj fotografie cenon rëndë privatësinë e viktimës dhe ritraumatizon të gjithë të mbijetuarit e dhunës seksuale.

Ndërsa Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka njoftuar se do t'i nisë hetimet pas publikimit të fotografisë nga deputetja Flora Brovina për dhunimin e një 35-vjeçarje nga ushtarët serbë gjatë luftës në Kosovë.

sot nuk duhet t'i dënojmë krimet e regjimit serb, por duhet t'i vëmë në lëvizje mekanizmat e shtetit tonë për t'i dënuar këto krime. Fakti që sot, para 20 vjetësh, flasim për këtë temë, tregon se këto institucione nuk i kanë kryer detyrat e veta", ka thënë ai. Megjithatë, Hoti ka kërkuar

që komisioni shtetëror të mos jetë politik. "Kush nga ndërkombëtarët me të cilët do ta themelojmë do t'i besonte gjykimin të deputetëve për krimet e luftës në Kosovë. Prandaj, kjo qasje tregon mungesë të kulturës institucionale. Qëllimi mund të jetë i drejtë, por sa i

## Onkologjia, 20 mijë shërbime për katër muaj

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

**PRISHTINË, 16 MAJ** - Instituti i Onkologjisë në QKUK ka ofruar më shumë se 20 mijë shërbime brenda katër muajve të parë të vitit 2019 për pacientët të cilët janë të diagnostikuar me kancer. Gjatë kësaj kohe stafi mjekësor ka kryer 12 000 kontrole, ka dhënë 8 100 doza të kimioterapisë dhe 4 200 terapi intravenoze. Te lista e shërbimeve mjekësore hyjnë edhe 501 raste të reja të evidentuara me kancer në periudhën janar - prill 2019.

Drejtori i Onkologjisë, Ilir Kurtishi, ka thënë se në krahasim me vitin e kaluar, ka një rritje prej pesë përqindësh të rasteve të reja me këtë sëmundje. Sipas të dhënave të nxjerra nga raportet e punës për vitin

2018, në të njëjtën periudhë kohore kishte 475 pacientë. "Nuk është shumë alarmante kjo, pasi që, në krahasim me vendet fqinje, kemi numër shumë më të vogël. Në Maqedoni gati 5 000 raste të reja diagnostikohen në vit, me një popullatë pak ma të madhe se Kosova. Pra, tek ne përqindja e këtyre rasteve është shumë më e vogël. Një prej faktorëve është që ne jemi popullatë e re dhe nuk i mbërrim ato mosha të shtyra, kur kanceri është më i pranishëm", ka thënë Kurtishi. Kanceri i gjirit vazhdon të dominojë. Deri në këtë kohë janë paraqitur 121 raste. Në vendin e dytë radhitet kanceri i mushkërive me 82 raste. Kurse kanceri te tubi digjestiv, përfshirë lukthin, pankreasin dhe zorrën e trashë, ka prekur 109 pacientë. Kanceri i organeve



gjenitale është paraqitur te 108 persona, meshkuj dhe femra, ndërsa 83 raste janë identifikuar me kancer në organe të tjera.

Dr. Kurtishi më tutje ka theksuar evidentimi i rasteve bëhet me rregull. "Shpresojmë që shpejt të kemi edhe kancer-regjistër në

Kosovë, pra të kemi të dhëna të sakta për secilin qytetar të Kosovës i cili diagnostikohet me kancer", ka pohuar Kurtishi.

Pacientja N. K. është shprehur e kënaqur me mënyrën e trajtimit, derisa është habitur me rregullin dhe shërbimet e ofruara në Institutin e Onkologjisë të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës. "Shërbimi është shumë i mirë. Stafi mjekësor ka sjellje të shkëlqyeshme me ne. Neve një fjalë e mirë na shëron, e lëre më shërbimi i mirë. Nuk kam besuar që këtu ofrohen shërbime kaq të mira. Pasi kam hyrë këtu, e kam parë vetë. Nuk kam fjalë ta përshkruaj", ka thënë ajo.

Në Onkologji trajtohen më shumë se 1 500 pacientë, përfshirë pacientët që vazhdojnë trajtimin nga viti i kaluar dhe pacientët e paraqitur këtë katërmujor.

# British Council mbajti konferencën rajonale nën skemën e BE-së për profesionistët e rinj në Ballkanin Perëndimor

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 16 MAJ - Më 13 dhe 14 maj British Council ka mbajtur një konferencë rajonale në Tiranë si pjesë e skemës së Bashkimit Evropian për profesionistët e rinj në Ballkanin Perëndimor. Në këtë ngjarje pjesëmarrësit paraqitën gjetjet nga hulumtimet mbi sfidat kryesore të agjendës për anëtarësim në BE për Ballkanin Perëndimor dhe diskutuan për mësimet e nxjerra nga këto fusha. Diskutimet u pasuruan veçanërisht nga përvojat e pjesëmarrësve si pjesëtarë të shërbimeve të tyre përkatëse civile.

Konferenca ishte një platformë për profesionistët e rinj për t'i identifikuar mësimet e nxjerra nga përparimi i tyre drejt anëtarësimit në BE dhe për ta përdorur atë për ta përmirësuar administratën publike në rajon.

Në kuadër të skemës së profesionistëve të rinj të financuar nga BE-ja dhe implementuar nga Këshilli Britanik, duke filluar nga tetori

2016, në kuadër të projektit, generata e tretë e pesë shërbyesve civilë nga secili shtet nga Ballkani Perëndimor, kaluan dy javë në Institutin d'Etudes Politiques (Sciences Po) në Paris në dhjetor 2018, po ashtu vijuan edhe një program në Kolegjin e Evropës (College of Europe) në Bryzh në janar 2019 dhe bënë një shkëmbim rajonal në gjashtë kryeqytetet në mars 2019.

Përgjatë këtij shkëmbim rajonal grupet u angazhuan në hulumtime dhe analiza në fushat relevante për anëtarësim në BE dhe agjendën e zhvillimit në Ballkanin Perëndimor, bazuar në përvojën e tyre si nëpunës civilë.

Qëllimi kryesor i konferencës në Tiranë ishte që të gjashtë grupet të paraqesin gjetjet e hulumtimit të tyre dhe të elaborojnë për rritjen e rolit të profesionistëve të rinj për një administratë publike moderne dhe efikase në rajon.

Temat që u trajtuan në konferencë mbuluan reformat e drejtësisë në kuadër të procesit të pranimit në BE; përmirësimin e sigurisë,



migracionit dhe menaxhimit të kufirit; mundësitë e bashkëpunimit ndërmjet WB6 në drejtësi dhe siguri, zbatimin e reformave kyçe të nevojshme për ta përshpejtuar pranimitin në BE; praktikën më të mira të BE-së dhe mësimet mbi politikën dhe veprimet e arsimit, punësimin dhe mobilitetin; forcimi i bashkëpunimit rajonal dhe dialogut ndërkulturor në Ballkanin Perëndimor; tranzicioni në ekonomi digjitale për rritje më të shpejtë, shërbime të përmirësuara dhe krijimin e vendeve të punës; a siguron agenda e ndërlidhjes stimuj të mjaftueshëm drejt një bashkëpunimi rajonal të qëndrueshëm?

Fjalimet mirëseardhëse u bënë nga Daniela Çekani, përfaqësuese e Qeverisë së Shqipërisë, Stephen Stork, udhëheqës i operacioneve, BE delegacioni i Shqipërisë dhe

Angus Bjarnason, zëvendës drejtor i Ballkanit Perëndimor British Council.

Daniela Çekani ka theksuar se mekanizmat si kjo skemë duhet të shumëzohen, sepse ato japin një vlerë të madhe në përmasa të shumëllojshme: njohuri, praktikë, ekspertizë, shkëmbim, lidhshmëri, bashkëpunim, pajtim, rrjetëzim etj. "Bashkëpunimi rajonal është gjithashtu i rëndësishëm kur bëhet fjalë për çështjet politike dhe institucionale që vendet përdorin për t'i gjetur dhe forcuar interesat e përbashkëta si dhe për t'i nxitur interesat e tyre kombëtare. Ky komponent shpesh konsiderohet vetëm në nivelet më të larta politike, duke harruar se në nivelet më të ulëta bashkëpunimi rajonal forcohet dhe praktikohet masivisht në baza ditore. Programet si YPS kontribuojnë shumë drejt arritjes

së një bashkëpunimi rajonal të zgjeruar", ka thënë Çekani.

Kurse Stephen Stork ka thënë se duke u bazuar në përvojën pozitive të programit "Profesionistët e rinj në Ballkanin Perëndimor" BE në Shqipëri mirëpret programin e ri për ngritjen e kapaciteteve të nëpunësve civilë.

Ndërkaq Angus Bjarnason ka theksuar se si British Council janë shumë të lumtur të jenë të përfshirë në programin e profesionistëve të rinj të Ballkanit Perëndimor pasi, sipas tij, bashkëpunimi dhe puna përtej kufirit janë në zemër të asaj që bënë British Council. "Ky program ofron një model të shkëlqyeshëm për profesionistët e rinj për vendet WB6 të cilat së bashku ndajnë përvojat dhe zhvillojnë qasje të reja për sfidat e përbashkëta", ka deklaruar Bjarnason.



## Ministri Tahiri: Sistemi i drejtësisë nuk do ta lejojë abuzimin me taksat e qytetarëve

PRISHTINË, 16 MAJ (ER) - Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka marrë pjesë në takim përmblyllës të Projektit të Binjakëzimit "Fuqizimi i formulimit të politikave dhe hartimit të legjislacionit", i menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë (ZBE) dhe i realizuar nga Fondacioni Gjerman për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar (IRZ).

Tahiri ka thënë se sundimi i ligjit është alternativa e vetme e cila garanton perspektivë të qartë evropiane për Republikën e Kosovës dhe në këtë drejtim ai ka theksuar se është angazhuar dhe angazhohet për luftë të pakompromis të dukurive negative të cilat e rrënojnë këtë të ardhme për qytetarët tanë. "Viti 2018 për Ministrinë e Drejtësisë dhe për mua si ministër ka qenë i ngarkuar me agjendën legjislative në të cilën i kam adresuar të gjeturat e raportit për vendin në tre vjetët e fundit, përfshirë

pakon e ligjeve të gjyqësorit, pakon e ligjeve që ndërlidhen me luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, siç ka qenë Ligji për konfiskim, Ligji për mbrojtjen e sinjalizuesve, pakoja e ligjeve që lidhet me të drejtat pronësore dhe ligje të tjera ku kemi marrë një mbështetje të rëndësishme nga këta ekspertë të cilët kanë punuar në këtë drejtim dhe në harmonizimin e këtij legjislacioni me atë të Bashkimit Evropian. Këto ndryshime normative janë përgjigja më e mirë që institucionet tona u kanë dhënë keqpërdoruesve, shkelësve të ligjit, duke u dhënë mesazhe të qarta se vendi ynë nuk do të tolerojë veprime të tilla, se pasuria e përfituar në mënyrë të jashtëligjshme do të konfiskohet pa përjashtim", ka thënë Tahiri.

Ai ka shtuar se sundimi i ligjit ende vazhdon të mbetet sfidë. "Kjo sfidë mund të adresohet



përmes zbatimit efikas të këtyre ligjeve, të cilat jam përkujdesur të jenë në pajtim me standardet e Bashkimit Evropian. Qëllimi i Republikës së Kosovës është që në të ardhmen të jemi pjesë e familjes së madhe evropiane dhe për këtë angazhohemi çdo ditë që në kuadër të sektorit të

sundimit të ligjit, ky legjislacion të jetë në koordinim të plotë me legjislacionin e Bashkimit Evropian", është shprehur ai. Ministri Tahiri ka thënë se puna e bërë për dy vjet e gjysmë nga projekti "Fuqizimi i formulimit të politikave dhe hartimit të legjislacionit" në fushën e plan-

ifikimit strategjik, hartimit të legjislacionit, përafrimit ligjor dhe monitorimit të zbatimit të ligjeve, marrëdhënieve me publikun, si dhe në procesin e rishikimit funksional të sektorit të sundimit të ligjit, është jetike për modernizimin e drejtësisë në Kosovë.

Është mbajtur akademi politike dhe shkencore me rastin e 20-vjetorit të zhdukjes së veprimtarit Ukshin Hoti

## Ukshin Hoti ishte veprimtar, intelektual dhe ideolog

"E vërteta për Ukshin Hotin dikush thotë se nuk dihet. Ajo dihet çdo ditë. Ai ishte veprimtar, intelektual dhe ideolog. Kur ka folur ai se Kosova duhet të ketë ushtri, shtet, pakkush ka guxuar të flasë", kështu ka thënë kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, me rastin e 20-vjetorit të zhdukjes së veprimtarit Ukshin Hoti



**EPOKA  
ERE** Qendresa RAMA

**PRIZREN, 16 MAJ** - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka thënë të enjten në Prizren, në 20-vjetorin e zhdukjes së veprimtarit të shquar Ukshin Hoti, se ai ishte ideolog dhe vizionar i madh për të ardhmen e shtetit të Kosovës. Kryeparlamentari Veseli ka thënë se Serbia do të përgjigjet para drejtësisë për zhdukjen e Ukshin Hotit dhe gjenocidin që e ka kryer gjatë luftës në Kosovë. "Andin, baba yt është baba i kombit tonë këtu në Kosovë. E

vërteta për Ukshin Hotin dikush thotë se nuk dihet. Ajo dihet çdo ditë. Ai ishte veprimtar, intelektual dhe ideolog. Kur ka folur ai se Kosova duhet të ketë ushtri, shtet, pakkush ka guxuar të flasë. Unë besoj shumë se kombi ynë ka perspektivë dhe do të jetë i fortë çdo ditë. Është i përjetshëm kujtimi për të madhin Ukshin Hoti. Ne sot do të kemi seancë të veçantë në Kuvendin e Kosovës për të kërkuar drejtësi për të gjithë ata mijëra qytetarë të vrarë, fëmijë, gra dhe pleq të cilët janë vrarë e masakruar nga shteti serb. Shteti serb ka kryer gjenocid.

Kjo duhet të thuhet edhe më me zë dhe shteti serb do të përgjigjet ashtu siç e meriton", ka thënë Veseli.

Ai ka shtuar se brezat e rinj të shtetit të Kosovës nuk duhet ta harrojnë sakrificën e gjeneratave të mëparshme që kanë bërë gjithçka për këtë liri që sot të gjithë e gëzojnë në shtetin e pavarur dhe sovran të Kosovës. "Të dashur të rinj, besoni në shtetin e Kosovës, sepse kemi bërë shumë sakrificë. Kemi shumë e shumë njerëz që kanë dhënë çdo gjë, edhe jetën për këtë shtet i cili sot e përgjithmonë do të ekzistojë. Unë besoj se kombi ynë ka perspektivë, se

shteti ynë po ecë çdo ditë përpara për aq sa duhet të kemi besim te njëri-tjetri për të ecur edhe më shpejt përpara. Ne do të ecim përpara ballëllartë dhe do të kërkojmë të drejtën tonë, do të kërkojmë drejtësi", ka thënë kryeparlamentari Veseli. Në akademinë politike dhe shkencore me rastin e 20-vjetorit të zhdukjes së veprimtarit Ukshin Hoti, organizuar nën përkujdesjen e Zyrës së Kryeministrit, kreu i qeverisë, Ramush Haradinaj, ka thënë se është nder për të që ndodhet për të dhënë një kontribut modest për ndriçimin ose bërjen dritë të jetës, veprës, sakrificës

së bashkëkombësit shumë të çmuar, Ukshin Hoti.

Kryeministri Haradinaj, pasi përshëndeti mundësinë e mirë që po ua jep Universiteti "Ukshin Hoti" në Prizren për konferencën shkencore dhe politike, inkurajoi studiuesit, të rinjtë dhe gjithë të tjerët, që të kthehen në traditë, që çdo herë ta lartësojnë veprën e bashkëkombësit, një bashkëkombësi të madh, profesorit Ukshin Hoti.

Nga një fjalë rasti në këtë akademi mbajtur kryetari i Komunitetit të Rahovecit, Smajl Latifi dhe deputeti Andin Hoti.



## Ministri i Mbrojtjes: FSK-ja me mandatin e ri do të jetë forcë profesionale dhe shumetnike

**PRISHTINË, 16 MAJ (ER)** - Në mjediset e Ministrisë së Mbrojtjes, për herë të parë pas miratimit të ligjeve për Ministrinë dhe FSK-në, ka filluar punimet konferenca dyditore "FSK-ja dhe partnerët 2019-I", me pjesëmarrje të atashëve të mbrojtjes të shteteve partnere, KFOR-it dhe Ekspicit Këshillues Ndërlidhës të NATO-s për Ministrinë e Mbrojtjes (MM) dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës (NALT/MM/FSK).

Në hapjen e punimeve të konferencës morën pjesë edhe ministri i Mbrojtjes Rustem Berisha, zëvendësministrat Burim Ramadani dhe Agim Çeku, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, sekretari i përgjithshëm Shkëlzen Sylaj, drejtori i Drejtorisë për Politika dhe plane Faruk Geci, komandanti i KFOR-it, gjeneral-major Lorenzo D'Adario, drejtori i NALT-it, gjeneral Uwe Becker, si dhe gjeneralë dhe oficerë të FSK-

së, KFOR-it dhe NALT-it si dhe atashë të FSK-së.

Në fjalën e tij hyrëse, ministri i Mbrojtjes, Rustem Berisha, u shprehu falënderime të gjithë atashëve ushtarakë dhe atyre të mbrojtjes të shteteve të rajonit, shteteve partnere, shteteve të NATO-s si dhe të gjithë të ftuarve të tjerë. "Falënderoj shtetet partnere në krye me ShBA-në, NATO-n për mbështetjen e vazhdueshme që na e kanë dhënë dhe po vazhdojnë të na japin në zhvillimin e FSK-së. Të gjitha të arriturat e FSK-së janë suksese të përbashkëta dhe kjo histori suksesi është e Kosovës dhe aleatëve perëndimorë. FSK-ja edhe me mandatin e ri do të jetë forcë profesionale, shumetnike dhe e besueshme, ku diversiteti është dhe do të mbetet vlerë, ku barazia është për të gjithë. Për Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-në, qytetarët e Kosovës janë të gjithë të barabartë. Ministria e Mbrojtjes dhe FSK-ja



bashkëpunojnë me këshilltarët e NALT-it për çdo ditë. Me këtë rast dëshiroj t'i falënderoj për ndihmën këshilluese dhe përkrahjen e vazhdueshme që po na japin për zhvillimin e FSK-së. Ne jemi të kënaqur me bashkëpunimin dhe bashkërendimin që kemi tash e 20 vjet me misionin e KFOR-it në Kosovë, të cilëve dua t'u falënderohem për ruajtjen e paqes dhe stabilitetit në Kosovë dhe rajon. Republika e Kosovës

është përkushtuar për paqe, siguri, stabilitet dhe bashkëpunim me të gjithë. Ne jemi të bindur se paqja e përhershme arrihet me anëtarësimin e secilit shtet të rajonit në NATO", ka thënë Berisha.

Edhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, ka thënë se FSK-ja ka avancuar dukshëm në ngritjen e kapaciteteve. Në punimet e konferencës së parë për vitin 2019 "FSK-ja dhe

partnerët" po marrin pjesë atashë të Mbrojtjes nga Shqipëria, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Mbretëria e Bashkuar, Kroacia, Turqia, Maqedonia, Mali i Zi, Gjermania, Italia, Hungaria etj.

Konferenca do t'i vazhdojë punimet edhe sot (e premte) me prezantimin e nevojave dhe projekteve të disa prej fushave me interes të veçantë për zhvillimin e Forcës në këtë fazë.

## Inspektorati i punës, 20 inspektorë më tepër

PRIZREN, 16 MAJ (ER) - Mosrespektimi i të drejtave të punëtorëve dhe mosofrimi i kushteve të sigurta për punë është bërë fenomen shqetësues në Kosovë. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, sipas zëvendësministrit Besnik Berisha, është angazhuar së fundmi për lehtësimin e një dialogu social në mes të punëdhënësve dhe punëmarrësve, në mënyrë që të informohen dhe vetëdijesohen për rëndësinë që ka marrja e masave të domosdoshme për siguri dhe shëndet në punë. Këto deklarime Berisha i ka bërë të mërkurën në panelin e diskutimit me temë "Rëndësia e sigurisë në punë", në Kinemanë

"Lumbardhi" në Prizren, nën organizimin e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë dhe Ministrisë së Integritimit Evropian.

Përmes Inspektoratit të Punës Berisha ka thënë se synohet rritja e numrit të inspektimeve dhe fuqizimi i këtij institucioni. "Është zotim yni që brenda këtij viti ta rrisim numrin e inspektorëve dhe besoj se deri në fund të vitit do t'i kemi edhe 20 inspektorë të rinj", është shprehur Berisha.

Ndërsa Libor Chlad, zëvendës shef për Bashkëpunim në Zyrën e Bashkimit Evropian në Kosovë, ka deklaruar se situata e sigurisë në punë në Kosovë

mbetet ende e panjohur. "E panjohur, pasi nuk ka regjistrim të strukturuar të aksidenteve në punë dhe ekziston një nevojë urgjente për të zhvilluar një sistem të bazuar në akte ligjore për t'i regjistruar të gjithë aksidentet në punë me tre dhe më shumë ditë pune të humbura siç bëhet në të gjitha vendet e BE-së, sipas Metodologjisë së Statistikave Evropiane për Aksidentet në Punë (ESAW)", është shprehur Chlad.

Në katër muajt e parë të këtij viti katër punëtorë kanë humbur jetën dhe mbi 25 të tjerë kanë pësuar lëndime në vendet e tyre të punës. Sipas zëvendëskryesinspektorit të Inspektoratit të

Punës në Kosovë, Agim Millaku, është në të mirën e punëmarrësve që t'i marrin masat adekuate për t'i mbrojtur punëtorët e tyre. "Në rast të ndonjë aksidenti, dëmet janë shumë më të mëdha për punëdhënësin sesa kursimi që ka tentuar ta bëjë duke mos i blerë pajisjet e nevojshme për mbrojtje të punëtorëve", është shprehur Millaku në Ferizaj, në tryezën e rrumbullakët me temën "Rëndësia e sigurisë në punë".

Eksperti për Siguri dhe Shëndet në Punë, Bekim Doli, i certifikuar edhe nga Inspektorati i Punës, ka shpjeguar në detaje para ndërtuesve në Prizren për masat që duhet të marrin në vendpun-

ishte. "Ndërtimi është aktivitet ku lëndimet janë të shpeshta dhe të përditshme dhe numri i tyre është gjithnjë e më i lartë. Ndërtimtaria prin si sektori me numrin më të madh të lëndimeve dhe vdekjeve në punë si pasojë e pasigurisë që vjen kryesisht nga mungesa e trajnimit të punëtorëve dhe nga mosrespektimi i rregullave bazë të sigurisë në punë", ka thënë Doli.

Ky panel diskutimi është organizuar në kuadër të projektit "Përkrahje për komunikim në procesin e integritimit evropian", që financohet nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë në bashkëpunim me Ministrinë e Integritimit Evropian.



## Kosova dhe Mbretëria e Bashkuar së shpejti me marrëveshje për tregti të lirë

PRISHTINE, 16 MAJ (ER) - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, gjatë takimit që zhvilloi me Andrew Mitchell, komisionarin e Tregtisë për Evropë të Mbretërisë së Bashkuar, ka theksuar se Mbretëria e Bashkuar ka kontribuar jashtëzakonisht shumë për ndërtimin e Kosovës. Shala shprehu mirënjohje për Mbretërinë e Bashkuar që është hisedare në lirinë dhe pavarësinë e Republikës së Kosovës, duke shtuar se marrëdhëniet e shkëlqyera politike në mes të dyja vendeve të kthehen edhe në aspektin ekonomik. Ministri Shala dhe komisionari Mitchell u pajtuan që së shpejti të nënshkruhet edhe marrëveshja në mes të Kosovës dhe Mbretërisë së Bashkuar për tregti të lirë. Shala ka shpjeguar

edhe potencialin që ka Kosova për investime të huaja, duke nisur nga energjia e ripërtitshme, investimi në miniera, në bujqësi dhe turizëm. Po ashtu, ministri Shala dhe komisionari i Mitchellit u pajtuan për iniciimin e marrëveshjes për mbrojtjen dhe promovimin e investimeve të Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë.

Komisionari Mitchell vlerësoi marrëdhëniet në mes të Kosovës dhe Mbretërisë së Bashkuar, duke bërë me dije se Britania ka interes t'i rrisë shkëmbimet tregtare dhe, po ashtu, ta rrisë praninë me investitorë.

Bashkë me komisionarin Mitchell në takim ishte edhe ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, Ruairi O'Connell.





# Fondi për Garanci Kreditorë për tri vjet ka krijuar 3 700 vende pune

Në përvjetorin e tretë të themelimit të Fondit Kosovar për Garanci Kreditorë (FKGK) u tha se për këtë periudhë janë dhënë 2 560 kredi të garantuara për biznese të vogla dhe të mesme në vlerë rreth 100 milionë euro që kanë arritur të krijojnë mbi 3 700 vende të reja pune në Kosovë



**EPOKA  
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 16 MAJ - Fondi Kosovar për Garanci Kreditorë (FKGK) ka shënuar të enjten trevjetorin e themelimit. Me këtë rast, është nënshkruar edhe marrëveshja me Fondin Evropian për Investime lidhur me Programin COSME.

Ambasadori gjerman në Prishtinë, Christian Heldt, ka thënë se Gjermania fokusin e veçantë në Kosovë e ka vënë në bujqësi dhe në mbështetje të sektorit privat. Ai ka thënë se këtë vit qeveria gjermane po vazhdon financimin për agrodritaren që u themelua në vitin e kaluar edhe për 6.5 milionë euro shtesë. "Do të dëshiroja që të shihja më shumë dritë në këto storie të biznesit sepse FKGK-ja është storie biznesi", ka thënë Heldt.

Gubernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Fehmi Mehmeti, ka thënë se ky fond gjatë këtyre tre vjetëve ka arrit-

ur një sukses të jashtëzakonshëm duke ndihmuar në zhvillimin ekonomik të vendit si dhe krijimin e vendeve të reja të punës. "Fondi ka shërbyer për tejkalimin e shumë sfidave ekonomike. Është me rëndësi që fondi ta rrisë edhe më shumë aktivitetin e tij. Fondi ka arritur të garantojë 100 milionë euro kredi. Studimet tregojnë se qasja në financa është pengesë, andaj me anë të këtij fondi bizneseve u është mundësuar qasje më e lehtë", ka thënë Mehmeti.

Zëvendësministri i Financave, Fatmir Gashi, ka thënë se kjo ministri është e përkushtuar ta mbështesë FKGK-në për garantimin e kredive. "Ne si ministri vazhdojmë të jemi të përkushtuar ta mbështesim Fondin Kosovar për Garantimin e Kredive. Shpresojmë që ky fond do të jetë shpresa e bizneseve të reja që të rinjtë të bëjnë një biznes më të mirë në Kosovë", u shpreh Gashi. Ndërsa Lisa Magno, drejtoreshë

e USAID-it në Kosovë, ka theksuar se 25 për qind e FKGK-së kanë shkuar për bizneset e vogla siç është prodhimtaria dhe bujqësia. Ajo ka thënë se FKGK-ja ka ndihmuar në krijimin e 3 700 vendeve të punës. "Po kremtojmë një bashkëpunim të BE-së dhe FKGK-së. Më shumë se 25 për qind e FKGK-së kanë shkuar për bizneset e vogla siç është prodhimtaria dhe bujqësia. Kjo ka ndihmuar në krijimin e 3 700

vendeve të punës", ka thënë ajo.

Ndërsa këshilltari i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, Durim Limaj, ka thënë se kjo marrëveshje është një lajm i mirëseardhur për bizneset vendore pasi u mundëson atyre një qasje më të lehtë në financa. "Inicimi i marrëveshjes së Cosme-s ka për qëllim formimin e një mundësie që bizneset tona të kenë edhe një derë të hapur që të jenë të

barabartë edhe me tregjet e tjera ndërkombëtare. MTI-ja është nënshkruese e marrëveshjes 'Cosme' dhe kemi një rol të rëndësishëm të këtij programi tek aktorët relevantë. Kjo marrëveshje është një lajm i mirëseardhur për bizneset tona për faktin se mundëson një qasje më të lehtë në financa. Kjo marrëveshje do t'u mundësojë bizneseve që t'ua bëjnë më të lehtë marrjen e kredive", është shprehur Limaj.

## Inaugurohet Oda Ekonomike Kosovë - Zvicër



PRISHTINË, 16 MAJ (ER) - Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Llluka, po qëndron në shtetin e Zvicrës ku, së bashku me ministrin e Ekonomisë së Zvicrës, Guy Parmelin, zëvendëskryeministrin Enver Hoxhaj dhe zëvendësministren Rejhan Vuniqi, bënë inaugurimin e Odës Ekonomike Kosovë - Zvicër.

Oda Ekonomike Kosovë - Zvicër ka për qëllim kryesor sjelljen e investitorëve nga ky shtet në Kosovë dhe anasjelltas përmes bashkëpunimit të ngushtë me diasporën. Ministri Llluka gjatë fjalimit inaugurues ka falënderuar të pranishmit për iniciativën dhe ka shprehur gatishmërinë për bashkëpunim, duke potencuar

avantazhet që ka Kosova në krahasim me vendet e tjera të Evropës. Ai iu drejtua diasporës duke kërkuar nga ajo që investimet e saj të orientohen nga patundshmëria në prodhim dhe shërbime, pasi këto të fundit kanë efekt pozitiv afatgjatë në ekonominë e vendit, duke marrë shembull investimin e realizuar në Gjilan nga biznes-

meni Fehmi Fetahu me projektin "Vali Ranch Resort & Congress Center" që ka dhjetëra të punësuar. Gjithashtu, ministri Llluka ka potencuar se Zvicra është një ndër tri vendet kryesore që ka investuar në Kosovë si me donacione, po ashtu edhe me investime direkte, që tregojnë se raportet në mes të dy vendeve

janë të shkëlqyera dhe iniciativat e tilla do të fuqizojnë këtë raport edhe më tej.

Ministri Valdrin Llluka ka zhvilluar takime të ndryshme me të pranishmit të cilët ishin në këtë delegacione nga Zvicra në Kosovë, me qëllim që të njoftohen nga afër me potencialet që ofron Kosova.

## Gjini takohet me ambasadorin turk, flasin për projektet e mbështetura nga TIKA

GJAKOVË, 16 MAJ (ER) - Kryetari i Komunës së Gjakovës, Ardian Gjini, ka pritur të enjten në takim ambasadorin

e Turqisë në Kosovë, Çagri Sakar. Gjatë këtij takimi kryetari Gjini dhe ambasadori Sakar kanë biseduar për mar-

rëdhëniet e të dy shteteve. Po ashtu, të dy bashkëbiseduesit kanë diskutuar edhe për projektet që janë mbështetur nga

Agjencia Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim (TIKA) dhe KFOR-i turk në Komunën e Gjakovës.



## Skenderaj përkujton pesë dëshmorët e kombit

SKENDERAJ, 16 MAJ (ER) - Nën kryetari i Komunës së Skenderajt, Nuredin Lushtaku, së bashku me drejtorët komunalë, deputetin e Kuvendit të Kosovës, Bekim Haxhiu, familjarët, asamb-

listët dhe përfaqësuesit e shoqatave të dala nga lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kanë bërë homazhe te varret e dëshmorëve të lirisë në përkujtim të 20-vjetorit të rënies së tyre në altarin e lirisë.

Me këtë rast janë përkujtuar Gani Uka e Muharrem Rexha në Ticë, Skender e Mustafë Skenderi në Kompleksin e Dëshmorëve në Marinë si dhe Kujtim Ahmetin në varrezat e dëshmorëve në Tërnafc.

## Shpërndahen 500 pako ushqimore për familjet me gjendje të rëndë sociale në Prishtinë

PRISHTINË, 16 MAJ (ER) - Komuna e Prishtinës ka njoftuar se në bashkëpunim me organizatën "Qatar Charity" kanë shpërndarë 500 pako ushqimore për familjet në gjendje të rëndë sociale dhe ekonomike. "Organizata 'Qatar Charity' në koordinim me Drejtorinë për

Mirëqenie Sociale dhe qendrat për punë sociale në Komunën e Prishtinës, shpërndanë 500 pako ushqimore për familjet në gjendje të rëndë sociale dhe ekonomike. Të ndihmojmë të gjithë nga pak, ata që kanë nevojë shumë!", ka njoftuar Komuna e Prishtinës.



## Ministria e Bujqësisë do ta vazhdojë përkrahjen e fermerëve dhe kultivuesve të Malishevës



PRISHTINË, 16 MAJ (ER) - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), Dijana Ziviq, ka pritur të enjten në takim kryetarin e Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, me të cilin ka biseduar për zhvillimet e deritanishme në sektorin e bujqësisë në këtë komunë si dhe për projektet e shumta komunale, sidomos atë në ndërtimin e sistemit të ujitjes

në fshatin Banjë. Ministria Ziviq e ka njoftuar kryetarin Begaj për format dhe mundësitë e përkrahjes dhe kanë diskutuar për bashkëpunimin ndërmjet dy institucioneve në favor të mbështetjes së fermerëve dhe kultivuesve nga kjo komunë. Ministria Ziviqi ka thënë se MBPZHR-ja do ta vazhdojë edhe më tej mbështetjen për fermerët dhe kultivuesit e

Malishevës edhe këtë vit. Ajo ka vlerësuar punën e kryetarit dhe fermerëve të kësaj ane, pasi është një nga komunat që i ka dhënë një rëndësi të madhe bujqësisë. Ndërsa kryetari i Malishevës, Ragip Begaj, ka falënderuar ministren Ziviq për përkrahjen dhe mbështetjen që MBPZHR-ja i ka ofruar dhe vazhdon t'i ofrojë zhvillimit të sektorit të bujqësisë në komunën të cilën ai e drejton.

## Lumi "Lepenc" me pamje të re, nga sot edhe me troftë

PRISHTINË, 16 MAJ (ER) - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka marrë në mbikëqyrje të mëtutjeshme lumin "Lepenc" pas rehabilitimit të tij në kuadër të ndërtimit të autostradës "Arbën Xhaferi". Me këtë rast, lumi u pasurua edhe më peshq të llojit troftë.

Ministri i Infrastrukturës dhe Transportit, Pal Lekaj, ka thënë se akti i sotëm është shembull i

mirë për qytetarët se si duhet ta trajtojmë ambientin duke e mbajtur të pastër atë. Ai ka shtuar se krahas projekteve gjigante infrastrukturore, MIT-ja është e përkushtuar që të mos e degradojë natyrën, por të ndihmojë në rehabilitimin e saj sa herë që ka nevojë.

Ministri Fatmir Matoshi ka falënderuar ministrin Lekaj dhe dikasterin që ai drejton për punën e shkëlqyer në rehabil-

itim të kësaj pjese të lumit "Lepenc".

Shtrati i lumit "Lepenc", në gjatësi prej gjashtë kilometrash, është i trajtuar me materiale natyrore të zonës, kurse që nga rehabilitimi i tij është vërejtur rikthimi i florës dhe faunës së kësaj zone. Njëkohësisht, lumi është pastruar nga mbeturinat dhe mbetjet urbane që ishin të pranishme para fillimit të punimeve.



# Lëreni presidentin Hashim Thaçi t'i realizojë të drejtat e shqiptarëve të Kosovës Lindore sepse ka të drejtë



**Spiro BUTKA**

Në shtypin e përditshëm dhe mediat vizive, të Prishtinës, Tiranës, Beogradit e disa kryeqyteteve evropiane, ka kohë që po sulmojnë presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi, për idenë e hedhur nga ana e tij, për bashkimin e tri komunave të Kosovës Lindore, atyre të Preshevës, Medvegjës e Bujanocit.

Ish-lideri politik i UÇK-së, tani në paqe me luftë politike, presidenti i Republikës së Kosovës po lufton dita-ditës për realizimin e aspiratave të shqiptarëve të kudondodhur, e në mënyrë të veçantë të atyre të Kosovës Lindore, të cilët, edhe pse derdhën gjak në atë luftë të pabarabartë, marrëveshja e Konçulit i ripushtoi në kundërshtim me Kartën Kombeve të Sanfranciskos dhe aktin final të Helsinkit. Kundër idesë së tij janë hedhur, gazetarë, analistë, politikanë, historianë, publicistë e të tjerë të kësaj natyre, të cilët duke vënë funksion rrufjanizmin politik, kuptohet që çojnë ujë në mullirin e atyre që i paguajnë. Në këto ujëra të turbullta notojnë dhe disa të tjerë, injorantë të nivelit fillestar arsimor e kulturor, të cilët të verbuar nga karrierizmi i sëmurë dhe etja për pushtet e lavdi, po i shërbejnë vullnetarisht Beogradit për ta realizuar ëndrrën e Perandorisë serbe. Por presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka plotësisht drejtë.

## Pse ka të drejtë presidenti Hashim Thaçi?

Në lindje të trevës shqiptare të Kosovës, nga veriu i Kumanovës e deri në jug të Nishit, shtrihet Lugina e Preshevës, e quajtur ndryshe Kosova Lindore. Brenda këtij rajoni tepër të rëndësishëm gjeostrategjik, përfshihen Presheva, Medvegja, Bujanoci, Vranja dhe Leskovaci. Këto komuna kanë gjithsej një sipërfaqe prej 1 249 kilometrash katrorë. Brenda tyre përfshihen 139 vendbanime, me mbi 250 mijë banorë, ku mbizotëron plotësisht popullsia etnike shqiptare. Beogradi, si epiqendra e nacionalizmit të

tërbuar serb, iu parapriu ditëve të sotme për ndarjen e kësaj krahine, duke manovruar dinakërisht, brenda preteksteve të ndarjeve administrative. Kjo, e thënë më shkoqur, u realizua me bekimin e plotë të kroatit Josif Broz Tito, i njohur për manovrat e tij politike, për shuarjen e zjarreve brenda gjinisë sllave. U pyetën apo jo shqiptarët, për ndarjen e tyre nga trugu amtar dhe bashkëngjitjen artificiale me gjininë serbe, të ardhur nga Uralet e Azisë së largët, këtë më mirë se kur e tregon referendumi i viteve të shkuara, me zhvillimin e të cilit, popullata autoktone shqiptare deklaroi dhe shprehu vullnetin e vet për ribashkim me Kosovën shqiptare. Kjo e drejtë është legjitime, e natyrshme dhe e patjetërsueshme. Treva e Luginës së Preshevës është pjesë e pandarë e territorit integral të Kosovës dhe e kompaktësisë etnike shqiptare. Burimet historike dëshmojnë se prania e shqiptarëve në këto komuna është e njëjtë si në të gjitha trojet e tjera etnike ku jetojnë shqiptarët, pavarësisht nga ndarja dhe krijimi i strukturave të tjera nacionaliste të pushtuesve serbë.

Në lashtësinë iliriane territori i këtyre komunave, bashkë me Kosovën dhe vise të tjera, gjendeshin brenda kufijve të shtetit të Dardanisë, me qendër në Shkup. Perandoria Romake i pushtoi këto treva ilire pa u cenuar kufijtë dhe emërtimet e tyre përkatës për vendndodhjen e gjuhësinë. Lufta e pasardhësve të Krishtit e ndau këtë perandori në dy pjesë, në atë Romake dhe të Bizantit, ku u përfshinë edhe trojet ilire. Pas pushtimeve serb-sllave, sidomos të Stefan Dushanit, pjesa më e madhe e tokave shqiptare u përfshi brenda kufijve të shtetit feudal mesjetar serb, me kryeqendër Rashkën. Në fillimet e shekullit të 15-të, Lugina e Preshevës, Kosova dhe i gjithë territori shqiptar u pushtuan nga Perandoria turke.

Në zgjerim e sipër të kufijve të vet, ajo nuk njohu ndarjet manipuluese të pushtuesve serbë. Në planet e reja të kësaj perandorie, komunat e Kosovës Lindore u njësuat të qenur sipas identitetit etnik, nën administratën e Sanxhakut të Prishtinës, si pjesë përbërëse e Vilajetit të Kosovës, me kryeqendër Shkupin, për gati pesë shekuj. Trazirat luftarake në Ballkan, Evropë e Botë, para dhe pas viteve 1900, u përçollën nga shqiptarët me pasoja

tragjike. Shën Stefani kurdisi copëtimin e shqiptarëve, në interes të zgjerimit të Perandorisë sllave dhe asaj helene, duke i hapur rrugë prapaskenave të Berlinit. Ky i fundit, ashtu si pa u ndjerë, punoi për skenarin e Londrës, për të marrë vendime vdekjeprurëse, për shqiptarët, popullin më të vjetër evropian, si trashëgimtarët e vetëm dhe unikë të popujve të lashtë pellazgjik.

Traktat pas traktati, bota u mblodh në Versajë, vendi ku u tentua për inekzistencën shqiptare, në gjeopolitikën botërore. Falë qëndrimit këmbëngulës e të patundur të presidentit të ShBA-së, që shqiptarët e sotëm vazhdojnë të jenë ata që kanë qenë, si pjesë e pandarë e kësaj shoqërie njerëzore. Pre e Versajës famëkeqe u bënë mbi dy të tretat e Shqipërisë dhe shqiptarëve. Fqinjët e veriut serbo-sllav dhe helenët grekë në jug, me zjarr e terror të paparë, pushtuan tokat shqiptare, të shitura nga tregtarët politikë reaksionarë evropianë. Në këtë gjakderdhje u përfshinë edhe komunat e Kosovës Lindore, të pandara nga vetë Kosova, por të bashkëngjitura artificialisht me mbretërinë serbe, të muaxhirëve sllavë në Ballkan.

Si fillim deri në vitin 1929, brenda një mbretërie serbo-kroate-sllavene, e cila më pas, deri në vitin 1941, për të afirmuar krimin politik, u vet emërtua si mbretëria e sllavëve të jugut. Brenda kësaj hartografie politike sllave, Kosova dhe Lugina e Preshevës u administruan si pjesë e Banovinës të Vardarit me qendër në Shkup.

Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, Beogradi e ndau Luginën e Preshevës në mënyrë arbitrare nga trugu shqiptar i Kosovës dhe ia bashkëngjiti Serbisë. Ndarja u bë me qëllime të caktuara dhe interesa të veçanta për Serbinë. Gjendja pozicionale gjeostrategjike e Luginës së Preshevës, si një nyje kyçe komunikacioni, në epiqendër të Gadishullit Ballkanik, ishte dhe mbeti një nevojë e domosdoshme e Beogradit për t'u lidhur me Nishin, Shkupin, Sofjen, Selanikun dhe Stambollin. Rrugët tokësore dhe hekurudhore në këtë luginë, duke u kryqëzuar ngushtazi, janë e vetmja lidhje e Serbisë me Maqedoninë, Greqinë, Bullgarinë dhe Turqinë. Diplomacia serbe, duke menduar se një ditë Beogradi do ta humbte Kosovën, e me atë rast edhe

drejtimin rrugor Beograd-Kralevë-Mitrovicë-Fushë Kosovë-Ferizaj-Shkup, veçoi Kosovën Lindore, për ta siguruar vijën tjetër me leverdi të shumëfishtë, që kalon nëpër Luginën e Preshevës.

Para se ta ndante Luginën e Preshevës nga Kosova, ajo mori një sërë masash paraprake, për t'i justifikuar hapat që hodhi, në vendimet që mori më vonë, në vitin 1945. Më 8-10 korrik të atij viti, nën mbikëqyrjen e rreptë të OZNA-s, në Prizren u mbajt Konferenca e Dytë e Këshillit NÇ për Kosovën dhe Dukagjinin.

Beogradi hodhi poshtë rezolutat e mëparshme, duke mos marrë parasysh fare strukturën etnike të popullatës dërrmuese shqiptare e, për më tepër, respektimin e vullnetit të popullit të kësaj treve etnike shqiptare. Aneksimin arbitrar të tokave Shqiptare, Beogradi e sanksionoi më 8 shkurt 1945, duke vendosur regjimin e rreptë ushtarak në Kosovë, nën komandën e gjeneralit serb Sava Dërleviç.

Pushtimin ushtarak të trojeve etnike shqiptare, Beogradi e shoqëroi me paragjykimet politike, duke korrigjuar të kaluarën, për t'i paraprirë të ardhmes.

Në vazhdimësi të politikës nacionaliste, të "Serbisë së Madhe", ai zgjodhi Prizrenin historik të shqiptarëve autoktonë, për t'i zhvlerësuar kuendet shqiptare, të vitit 1878, atë të vitit 1944 dhe marrëveshjen e Mukjes të marsit 1943. Komunistët e lidhjes specifike Jugosllave, duke teorizuar në pas Luftën Botërore, dogmat pacifiste të "bashkim-vëllazërimit", ngritën akuzën, se reaksioni shqiptar po kërkon bashkim kombëtar. Dhe për t'i dalë të keqes përpara, ndërthurën kurthe të reja, duke imponuar zgjidhjen, brenda diskutimeve komuniste.

Konferenca e Bujanit sfidoi marrëveshjen e Mukjes, në të njëjtën kohë mashtrroi shqiptarët, duke servitur para tyre, të drejtën për vetëvendosje në pasluftë. Premtime boshe, të përpunuara qëllimisht në kohën dhe vendin e duhur. I gjendur përballë kësaj situatë politike, Beogradi doli përpara botës demokratike, me një ndërtim të ri shtetëror, si Federatë Socialiste e Jugosllavisë, emërtim ky sa gloriifikues aq dhe butaforik i karagjorgjeviçëve pararendës. Socializmi specifik jugosllav, edhe pse u vetëquajt i tillë, në thelbin e vet nuk ndryshoi aspak qëllimin ogurzi, kundër

shqiptarëve të Kosovës e përkatësisht dhe ndaj atyre të Kosovës Lindore. Ngjarjet u pasuan me rrjedhoja të ndjeshme politike. Përndjekja dhe persekutimi i shqiptarëve të këtyre trojeve etnike, u shoqëruan, me arrestime, burgosje dhe vrasje politike. Dëbimet e detyruara nga trualli kombëtar, drejt Turqisë, Australisë, Amerikës dhe Evropës Perëndimore, u bënë motoja kryesore e Beogradit për realizimin e qëllimeve të veta kolonialiste në trojet etnike shqiptare, të pushtuara me dhunë e terror masiv. Bota përparimtare edhe pse heshti, në një farë mënyre i përçolli këto veprime politike të Serbisë, brenda dhe jashtë kufijve të pashallëkut të Beogradit si veprime të doktrinës së vjetër sllave, në zgjerim të kufijve perandorakë. Kohë pas kohe serbët nuk reshtën së vepruari për realizimin e qëllimeve nacionaliste. Edhe pse dinaku kroat Josif Broz Tito, herë pas here mori disa masa strukturore, për balancimin e rivaliteteve politike brenda kësaj bashkësie, Serbia nuk i gëlltiti ato por, ashtu si përherë, në rrugë e mënyra tinëzare, i mbajti nën gjuhën e vet, duke pritur e gjetur rastin e duhur për veprim.

Bota në vazhdimësi të zhvillimit të pandalshëm të shoqërisë njerëzore, pas vitit 1990, u përball me ndryshime të reja politike. Dy kampet antagonistë Lindje-Perëndim, duke sfiduar luftën, u shkrinë në një rend të vetëm, atë kapitalist. Fitoi Aleanca Atlantike, apo humbi Traktati i Varshavës, përcaktimi arsyetohet nëpërmjet arritjes të gjykimit parësor, ku ndryshimi cilësor dhe sasior i kthimit të dy sistemeve në një të vetëm, u realizua në mirëkuptim e pa gjakderdhje. Pikërisht këtu nisi t'i rinxjerrë kthetrat nacionalizmi i vjetër dhe i ri i Beogradit të tërbuar për "Serbi të Madhe".

Ecuria botërore e tërësisë demokratike manovroi së tepërmi brenda sistemit të koklavitur serbo-sllav të "Bashkim vëllazërimit", për t'u ndarë nga e kaluara. Hapin e parë e hodhi Sllovenia, pas asaj Kroacia dhe, në fund, boshnjakët që, pothuajse, u martirizuan për hir të qenies si myslimanë në qendër të Evropës. /Vijon/

(Autori është ish-drejtuues në Sh.O operacionin "Shigjeta" në luftën e UÇK-së. Aktualisht kryetar i ShVL të UÇK-së Tiranë)

**E jashtëzakonshme**

## 'Klientëve u shërbehet verë 5 700 dollarësh gabimisht'

Disa klientë me fat kanë provuar aksidentalisht një verë me vlerë 5 700 dollarë në një restorant. Restoranti "Hawksmoor Manchester" ka bërë një postim në "Twitter" ku shpresonte që klientët të ishin kënaqur nga vera e prodhuar në vitin 2001, "Cheatau le Pin Pomerol". Klientët porositën një verë me vlerë 330 dollarë, por morën një shishe me cilësi më të mirë, por me



çmim 17 herë më të lartë. Anëtar i stafit e bëri gabimin, por nuk u dënua nga pronari, pasi këto gjëra ndodhin në punë. Gabimi u kuptua nga menaxheri i restorantit.

## BARSOLETA E DITËS



- Alo, me Kryeministrinë po flas?
- Po. Çfarë mund t'ju ndihmoj?
- Dua të kandidoj për kryeministër. Cilat janë kushtet?
- Je i çmendur?!
- Jo. Kushte të tjera, a ka?



### Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjate vikendit ne ora 14:00

### "DUMBO" 3D

Fantazi/Familjar; 1 ore 52 min

**Rolet:** Colin Farrell, Michael Keaton, Danny DeVito, Eva Green, Alan Arkin, etj.  
**Regjia:** Tim Burton



**FOTO E DITES**



Punëtorët shihen duke punuar në pellgjet e avullimit të kripës në Peru. /AFP/

### Ne ora 16:00 dhe 19:00 "AVENGERS; Endgame"

Aksion/Aventurë/Fantazi; 3 ore 02 min

**Rolet:** Robert Downey Jr., Chris Evans, Mark Ruffalo, Chris Hemsworth, Scarlett Johansson, Don Cheadle, Bradley Cooper, Gwyneth Paltrow, Jeremy Renner, Josh Brolin, etj.  
**Regjia:** Anthony Russo, Joe Russo



Në ora 20:00

### "EXTREMELY WICKED, SHOCKINGLY EVIL, AND VILE"

Krim/Mister; 1 ore 48 min

**Rolet:** Zac Efron, Lily Collins, Kaya Scodelario, Jeffrey Donovan, Angela Sarafyan, Dylan Baker, John Malkovich, etj.  
**Regjia:** Joe Berlinger



**E rrallë**

## Nëna lind në autobus, udhëtime falas për vogëlushen deri në moshën 18-vjeçare

Gjatë udhëtimit me autobus nga Barcelona në Bruksel, një grua solli një vajzë të shëndetshme në botë. Gruas i erdhën dhimbjet e lindjes derisa po udhëtonte për t'i vizituar pjesëtarët e familjes. Pasi lindi fëmijën në autobus gruaja u dërgua



menjëherë në spital. Si nëna ashtu edhe foshnja ndodhen në gjendje të mirë shëndetësore. Kjo është hera e parë në historinë e FlixBus që një foshnje lind në autobus, ndaj vajza do të udhëtojë falas në FlixBus derisa të mbushë 18 vjeç.



16.05.2019

### "THE HUSTLE"

Komedi

**Rolet:** Anne Hathaway, Rebel Wilson, Alex Sharp, Dean Norris, etj.

Regjia: Chris Addison

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**

Sot jeni të ndjeshëm dhe nuk keni aq

shumë nerva të ftohta sa të përballoni qoftë edhe provokime të vogla. Do të nisni një debat të kotë me një mikun tuaj.



**DEMI**

Jeni të gatshëm të hidheni në lojë nga ana

sentimentale. Doni të rifilloni të buzëqeshni pas një zhgënjimi që ju la jo pak shenja.



**BINJAKËT**

Sot do të bezdiseni në ambientin e

punës, por si amortizator kundër mërzisë keni emocionet dhe ndjenjat e ëmbla që po provoni.



**GAFORRJA**

Jeni në një sintoni të plotë me veten

tuaj dhe këto kohë po ju ndihmojnë për ta gjetur ekuilibrin tuaj të brendshëm dhe për të reflektuar.



**LUANI**

Do të ketë një ndryshim të rrënjë-

sishëm në rrethin e personave që do ta njihni së fundmi. Kjo do të reflektojë mjaft për mirë edhe në jetën tuaj.



**VIRGJËRESHA**

Në këto çaste nuk po tregoheni

dhe aq racionalë sa duhet dhe po lini shkak për keqkuptime. Mundohuni të gjeni një rrugëdalje.



**PESHORJA**

Në ditën tuaj ka të reja dhe mjaft

dinamizëm në çdo situatë. Mbani sytë hapur sepse mund ta takoni shpirtin binjak aty ku s'e mendoni.



**AKREPI**

Nëse keni një punë që ka lidhje me

kreativitetin, besojini instinktit tuaj të parë. Do të jetë mjaft interesante vijueshmëria e ditës.



**SHIGJETARI**

Gjërat e vogla që mund t'ju duken të

parëndësishme janë ato që do t'i japin kuptim ditës suaj sot.



**BRICJAPI**

I jeni përkushtuar diçkaje që nuk ka dalë

aq me themel sa ju e mendoni. Siguritë false që keni pasur do të fillojnë të lëkunden papritur.



**UJORI**

Keni shumë gjëra për të arritur sot

dhe nuk do të përqendrohni vetëm në një pikë. E rëndësishme është që po merreni me veten.



**PESHQIT**

Shumë shpejt do t'i shikoni me sy

tjetër disa probleme të vogla që keni sot. Pasi të arrini t'i zgjidhni do t'ju duket çudi se sa pranë e kishit zgjidhjen.

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri

Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

# Islami: Nuk kemi frikë nga Prishtina, titulli është i 'Niklit'

Përparim Islami i ka dërguar porosi skuadrës së Prishtinës, se futbollistët e Feronikelit nuk ia kanë frikën dhe se titulli i kampionit do të shkojë në Drenas. "Interesimi është shumë i madh në Drenas. Pritet që stadiumi të mbushet. Normalisht se ata i motivojnë futbollistët. Sa i përket kundërshtarit, ai ka ekip cilësor, por nuk kemi aspak frikë nga ai sepse jemi lojtarë me përvojë dhe secili lojtar është kampion brenda skuadrës. Titulli do të jetë i 'Niklit', ka thënë Islami

**EPOKA E RE**

Veton ZYMBERI


PRISHTINË, 16 MAJ - Skuadrës së Feronikelit në derbin ndaj Prishtinës i mjafton edhe barazimi që të shpallet kampion në IPKO Superligën e Kosovës në futboll. Përparim Islami ka thënë të enjten për "Epokën e re" se shtabi teknik do të vendosë se si do t'i qaset ndeshjes kryesore në edicionin 2018/2019, por është i bindur se "Nikli" do të shpallet kampion i Kosovës. "Jemi shumë afër titullit të kampionit. Assesi nuk bën të gabojmë në ndeshjen e fundit. Se si do t'i qaset skuadra kësaj ndeshje, do të vendosë shtabi teknik, por është pozitiv për ne fakti se kemi në opsion dy rezultatet: fitoren dhe barazimin. Në futbollistët jemi të gatshëm të luajmë ashtu siç kemi bërë deri tash dhe ta përmbushim objektivin në kampionat duke e fituar trofeun", ka thënë Islami.

Mbrojtësi i djathtë pret që atmosfera të jetë madhështore të dielën në stadiumin "Rexhep Rexhepi", kurse konfirmim se Feronikeli nuk ka aspak frikë nga Prishtina. "Interesimi është shumë i madh në Drenas. Pritet që stadiumi të mbushet. Normalisht se ata i motivojnë futbollistët. Sa i përket kundërshtarit, ai ka ekip cilësor, por nuk kemi aspak frikë nga ai sepse jemi lojtarë me përvojë dhe secili lojtar është kampion brenda skuadrës. Titulli do të jetë i 'Niklit', ka thënë Islami. Nëse Feronikeli e fiton titullin e kampionit, atëherë do të jetë i dyti për Përparim Islamit në karrierë, sepse një të tillë e pati marrë dy vjet më parë me skuadrën e Trepçës '89. "Një titull e kam fituar sa isha pjesë e '89-shit. Besoj se edhe tash do ta fitoj me Feronikelin. Luftimi për titull dhe Kupë është arsyeja që kam zgjedhur të vij në këtë klub", ka shtuar Islami.

Një javë pa përfunduar kampionati, Feronikeli është skuadër lidere me 77 pikë, dy më shumë se Prishtina. Skuadra që drejtohet nga Zekrija Ramadani ka regjistruar 24 fitore, 5 barazime dhe 3 humbje.

## Ferizaj siguron mbijetesën, Gjilani ende shpreson

KF Ferizaj ka tejkaluar parashikimet dhe ka siguruar mbijetesën në elitë, pa pasur nevojë të luajë në barazh.



Skuadra e Bylbyl Sokolit të enjten në Obiliq e mposhti KEK-un (2-5) dhe në këtë mënyrë arriti të një sukses i madh, që është mbetja në Superligë. Golat për KEK-un i shënuan Isa Eminhaziri dhe Leonat Vitija, kurse për Ferizajn shënuan Dardan Çerkini, Erman Krasniqi, Blerton Mehmeti, Qëndrim Dautaj dhe Ylber Luma. Një hap të madh drejt mbetjes në elitë e

ka bërë edhe Gjilani. Skuadra nga Anamorava e mposhti Lirinë me rezultat bindës 4-0. Dy gola për Gjilani i realizoi Keita Rezak, kurse nga një gol e shtuan Fiton Hajdari dhe Ansi Nika. Pas kësaj fitore skuadra e Gjilanit ka shtuar gjasat për mbijetesën, pasi tash ka grumbulluar 38 pikë dhe është një pikë pas Trepçës '89 dhe dy pas Ballkanit dhe Drenicës.

## SHKURT

### Pesë euro çmimi i biletave për ndeshjen Feronikeli - Prishtina

Derbi i xhiros së fundit në Superligën e Kosovës në futboll zhvillohet në mes të Feronikelit dhe Prishtinës. Klubi i Feronikelit ka njoftuar se biletat do të shiten çdo ditë nga ora 10:00 deri në orën 15:00 në restorant 'Dijamant' në Drenas. "Fëmijët nën moshën 15-vjeçare nuk do të lejohen të futen në stadium edhe nëse kanë biletë. Çmimi për një biletë është pesë euro, kurse një person mund t'i blejë maksimumi dy bileta", thuhet në njoftimin e Feronikelit.

### Salihu, Feronikelit: Jeni të obliguar të ndani bileta për 'Plisat'

Feronikeli dhe Prishtina kanë para vetes edhe 90 minuta për ta përcaktuar kampionin e ri të Kosovës në futboll. Skuadra nga Drenasi ka bërë njoftimin e parë zyrtar rreth nxjerrjes së biletave në shitje ku, ndër të tjera, parashihet që fëmijët nën moshën 15-vjeçare nuk do të lejohen në fushë.

Sekretari i Përgjithshëm i FFK-së, Eroll Salihu, ka thënë se ky vendim i 'Niklit' është absurd dhe nuk bazohet në asnjë rregullorë. "Askund nuk shkruan se u ndalohet fëmijëve pjesëmarrësja në fushë. Për çka luhet futbollit, për tifozët të grupmoshave të ndryshme", ka thënë Salihu për "Telegrafin".

Salihu foli edhe për biletat, duke ia rikujtuar Feronikelit se skuadra vendëse është e obliguar që një pjesë të tribunave t'ua ndajë tifozëve mysafirë. "Nikli" ka paralajmëruar federatën se një pjesë e stadiumit është duke u ndërtuar. Por, kjo nuk do të thotë se nuk duhet të jenë të pranishëm tifozët e ekipit kundërshtar në shkallët e stadiumit, por edhe zyrtarët e mysafirët prishtinas. Feronikeli ka krijuar një traditë të mirë të mikpritjes së kundërshtarëve. Nuk besoj se do të ndodhë një gjë e tillë", ka shtuar Salihu.

### Xhaka mund të largohet nga Arsenali, Shaqiri nga Liverpooli

Dy futbollistët shqiptarë të Zvicrës, Granit Xhaka dhe Xherdan Shaqiri, mund të largohen nga skuadrat aktuale, Arsenal dhe Liverpool, në afatin kalimtar të verës. Lajmi është bërë publik nga "Daily Mail". Unai Emery duket se nuk e ka në planet e veta mesfushorin Xhaka për sezonin e ri, prandaj në verë ish-anëtari i Bazelit mund t'i bashkohet skuadrës së Interit. Në anën tjetër, Shaqiri nuk është zgjidhja e parë për Jurgen Kloppin dhe kjo mund të ndikojë në largimin e tij nga "Anfield"-i.

## Besa - Kastrioti dhe Vushtrria - Istogu janë finalet e hendbollit

**PEJË, 16 MAJ** - Besa Famgas - Kastrioti është finalja e meshkujve në Superligën e Kosovës në hendboll (meshkujt). Besa në finale arriti pas fitores edhe në ndeshjen e dytë ndaj Vëllaznimit (37:12). Ndërsa Kastrioti finalen e siguroi, pasi e mposhti Prishtinën me rezultat 32:26. Ishte kjo

fitorja e dytë e Kastriotit në gjysmëfinale të "play-off"-it ndaj Prishtinës. Ndërsa në Superligën e femrave finalen e siguruan Vushtrria dhe Istogu. Vushtrria me fitoren 24:22 ndaj Prishtinës e siguroi kualifikimin në finale, pasi edhe ndeshjen e parë e kishte fituar në Vushtrri (26:19). Ndërsa

Istogu e ka fituar edhe ndeshjen e dytë ndaj Shqiponjës dhe për herë të parë do të luajë në finale të "play-off"-it. Në ndeshjen e dytë gjysmëfinale të luajtur në Gjakovë, Istogu fitoi ndaj Shqiponjës me rezultat 31:25. Ndeshjen e parë të luajtur në Pejë, Istogu e kishte fituar me rezultat 35:26.



## Saviqeviqi: Nuk pres që lojtarët serbë të reagojnë ndaj himnit të Kosovës

**PODGORICË, 16 MAJ** - Presidenti i Federatës Malazeze të Futbollit, Dejan Saviqeviq, ka thënë se ndeshja kualifikuese për Evropianin 2020, ku Mali i Zi do ta presë Kosovën në Podgoricë, do të jetë si të gjitha ndeshjet e tjera. "Pres që të gjithë të sillen sikurse edhe ndaj himneve të tjerë. Nuk ka aty ndonjë sjellje speciale, është një ndeshje sikurse të gjitha të tjerat", ka thënë Saviqeviq për "Tanjugun" dhe gazetën vjeneze "Prese" në Vjenë, ndaj spekulimeve se gjatë intonimit të himnit të Republikës së Kosovës do të mund të reagonin përfaqësuesit me prejardhje serbe të Malit të Zi.



Ai ka shtuar se si president i Federatës dhe përzgjedhësi Lubisha Tumbaković do të provojnë që ajo ndeshje të mos ketë asnjë rëndësi speciale në raport me të tjerat. "Do të luajmë

si është më së miri, të provojmë të fitojmë tri pikë dhe t'i mbajmë shanset për vend të dytë në grup", ka thënë më tej Saviqeviq. Ai ka thënë se puna më e vështirë për lojtarët dhe stafin profesional do të jetë përgatitja e lojës dhe motivimi i lojtarëve.


Ndeshja luhet më 7 qershor në Podgoricë në stadium të zbrazët

pasi që Komisioni Disiplinor i UEFA-s e dënoi Federatën Malazeze të Futbollit me një ndeshje lojë pa shikues për shkak të incidenteve në ndeshjen kualifikuese me Anglinë. Saviqeviqi mendon se ndëshkimi është shumë i lartë dhe se Mali i Zi nuk e ka merituar atë pasi që vendi i tij, siç thotë ai, nuk është shtet racist. "Por ndodhi që një grupi vogël prej shtatë-tetë personave të bëjë atë që nuk është dashur dhe ne morën ndëshkim drastik të cilin nuk e kemi merituar dhe të cilin do të duhet ta shpagojmë ndaj Kosovës. Kemi bërë ankesë, por nuk jam i sigurt nëse do të miratohet", deklaroi Saviqeviq.

Në këtë kuptim ai ka shtuar se ndeshja do të jetë e vështirë në aspektin sportiv, por që në çështjen organizative do të ketë më pak punë si pasojë e mungesës së tifozëve.

## Milwaukee përmbysi Toronton në fund dhe fiton finalen e parë

**MILWAUKEE, 16 MAJ** - Skuadra e Milwaukee ka fituar ndeshjen e parë të "play-off"-it në Konferencën e Lindjes, duke mundur 108-100 Toronton dhe udhëheq 1-0 serinë e takimeve. Një ndeshje ku skuadra vendëse udhëhoqi shumë pak minuta, disi në fillimin e lojës dhe më pas në fundin e saj. Gjithsesi, kaq mjaftoi për ta fituar këtë ndeshje të parë finale. Skuadra e Torontos në ëshumicën e kohës e pati lojën nën kontroll, madje u shkëput deri në 13 pikë. Për kanadezët u dalluan Leonard me 31 pikë e Lowry me 30, por të vetëm e patën të pamundur të triumfojnë. Pikërisht në fundin e ndeshjes erdhi përmbysja e Milwaukee, që triumfoi falë 29 pikëve e 11 reboundeve të Brook Lopezit. Mirë u paraqit edhe Giannis Antetokounmpo, që realizoi 24 pikë e 14 rebounde. Të dyja ekipet i aktivizuan shumë pak lojtarët e stolit. Milwaukee është skuadra



me rezultatin më të mirë të sezonit të rregullt në NBA dhe në të gjitha ndeshjet ka faktorin

fushë në favorin e saj. Edhe finalja e dytë do të luhet në fushën e saj pas 48 orësh.

KONFERENCA E LINDJES - FINALE 'PLAY-OFF'		
Milwaukee - Toronto	108-100	(1-0)
KONFERENCA E PERËNDIMIT - FINALE 'PLAY-OFF'		
Golden State - Portland		(1-0)

### SHKURT

#### City do të dënohet nga UEFA

Manchester City duket se do të dënohet për shkak të rregullave të vendosura nga UEFA për sa i përket "Fair-Play"-it financiar. Çështja tashmë do të kalojë në duart e Organit të Kontrollit Financiar të Klubeve. Këta të fundit do të vendosin për dënimin që do ta marrin kampionët e Anglisë, që rrezikojnë edhe përjashtimin e Evropës për një sezon. Për këtë reagoi menjëherë edhe klubi. "Manchester City është i zhgënjyer por, fatkeqësisht, nuk është i befusuar nga kërkesa, megjithëse rrjedhjet e medieve tregojnë se si ndodhi gjyqi. Akuzat për parregullsi financiare janë të rreme", thuhet në reagimin e Cityt.

#### De Jong: Do të vdes kur ta shoh Messin në stërvitje

Frenkie De Jong është pa dyshim blerja më e bujshme për afatin kalimtar të verës, të paktën deri tani. Mesfushori do të kalojë në radhët e Barcelonës, me katalanasit që do të derdhin në arkat e Ajaxit plot 75 milionë euro. Në kuadër të kalimit të tij në "Camp Nou", De Jong ka folur për mediat, ku ka dhënë një deklaratë mjaft interesante, teksa thotë se do të vdesë kur ta shohë Leo Messin të stërvitet me të. "Do të vdes kur ta shoh Messin në stërvitje. Thjesht do ta pasoj topin tek ai gjithmonë (qesh). Nuk do ta ndryshoj mënyrën e lojës sime. Nuk më intereson nëse do të jem në qendër të vëmendjes të Barcelona. Jam kurioz të di se si do të përshtatem atje. Pres me padurim të mësoj nga më të mirët", ka thënë De Jong.

#### Rivaldo: Guardiola në verë mund të rikthehet në Spanjë

